



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

*Nr.207, Datë 18.12.2017*

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR CILËSINË E FURNIZIMIT DHE  
PERFORMANCËN E SIGURISË SË RRJETIT NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1; neni 16; neni 19, gërma “h” dhe “j” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe neni 26 të “Rregullores për Organizimin, Furnksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, pasi shqyrtoi relacionin e “Rregullores së cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike” të përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

**Konstatoi se:**

1. Me Vendimin nr. 5, datë 27.01.2016, Bordi i ERE-s vendosi: “Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit”.
2. Me shkresën nr.132 Prot, datë 04.02.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, draftin e “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike” për opinion.
3. Me shkresën me nr.716 Prot. i ERE, datë 07.10.2016, kanë ardhur komente nga USAID mbi draftin e “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, duke propozuar vendosjen e një periudhe tranzitore lidhur me përmbushjen e këtyre detyrimeve, në kuadër të ristrukturimit të sektorit të energjisë elektrike dhe implementimit të Modelit të Ri të Tregut.
4. Në shkresën e saj me nr. 775/1 Prot i ERE, datë 18.11.2016, OST ka paraqitur komentet e saj, lidhur me draftin e “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike”.

së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar ndryshimet e nevojshme.

5. Me shkresën nr. 653 Prot, datë 04.10.2017, i është dërguar shoqërisë “OST” sh.a, edhe njëherë drafti i “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, me të gjithë ndryshimet e reflektuara si pasojë e propozimeve të ardhura.
6. Në përgjigje të shkresës nr. 653 Prot, datë 04.10.2017, shoqëria “OST” sh.a. me shkresën nr. 5315/1 Prot, datë 10.10.2017, ka paraqitur disa komente të tjera për draftin, të cilat janë shqyrtuar dhe reflektuar ndryshimet e nevojshme.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të miratojë Rregulloren “Për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”.(Bashkëlidhur)
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë shoqërinë “OST“ sh.a. dhe gjithë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**